REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.3408 Prot

Maliq, më 01.06.2026

VENDIM
Nr. 70, datë 29.05.2026

PËR
MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I SUBVENCIONIT TË QIRASË

Bazuar ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, nënpika 1.1, gërma "b", ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM Nr.459 datë.3.7.2019 "*Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin*", VKM Nr. 362, datë 29.5.2019 "*Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij*", VKB Nr.03 datë 08.01.2026, *Rishqyrtimi i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq Nr.148 datë 24.12.2025 për "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për Vitin 2026*", VKB nr.139 datë 26.11.2025 për "*Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.16 datë 30.01.2026 për "Miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim", Këshillit i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën përfundimtare të përfituesve nga programi i subvencionit të qirasë si dhe vlerën konkrete të subvencionit që përfiton çdo familje, sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur.

2. Për familjet me numër rendor 1,2 dhe 3 subvencioni fillon nga momenti i miratimit të listës së përfituesve me VKB nr.16 datë 30.01.2026 për "Miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim". Për familjen me numër rendor 4 subvencioni fillon nga momenti i lidhjes së kontratës noteriale të qirasë.

3. Efektet financiare do të mbulohen nga fondi i përfituar nga Buxheti i Shtetit, bazuar shkresës nr.3489/2 datë 18.05.2026 të MEI, "Mbi transferimin e fondeve buxhetore për programin e subvencionimit të qirasë" si dhe nga bashkia Maliq bazuar në VKB nr.16 datë 30.01.2026 për "Miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim", ku bashkia do të mbulojë 27% të vlerës së qirasë dhe buxheti i shtetit 73%, si rezultat i fondit faktik të miratuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit dhe drejtoria e Finances dhe Buxhetit.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", *i ndryshuar*.

Miratuar me 18 vota
Vota Pro 18
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

Tabela Nr.1 Lista e përfituesve nga programi i subvencionit të qirasë, për vitin 2026

Nr	Emër Mbiemër Atësi	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që i takon	Qiraja mes. e apart. në treg për strukturën qe i takon familjes (QR≤QM)	Të ardhurat familjare mujore (A)	Kategoria (sipas pikës 45.e nenit 2 të ligjit 22/2018), i ndryshuar	Aftësia përballuese sipas nenit 3 të ligjit 22/2018, i ndryshuar (AP)	Qiraja e përballueshme (QP=AP*A)	Vlera konkrete e Subvencionit në muaj (S=QR-QP)	Periudha e përfitimit
1	Dorjana Leka Alfred	2	1+1	7500	0	Pa te ardhura	0%	0	7500	30.01.2026 - 31.12.2026
2	Zamira Xhuti Nevzat	3	2+1	10000	0	Pa te ardhura	0%	0	10000	30.01.2026 - 31.12.2026
3	Katina Panajoti Mihallaq	1	G	5000	11573	Të ardhura shumë të ulëta	15%	1736	3264	30.01.2026 - 31.12.2026
4	Betrant Mehmetllari Myzafer	5	3+1	15000	0	Pa te ardhura	0%	0	15000	15.05.2026 - 31.12.2026

Miratuar me 18 vota
Vota Pro 18
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI